



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

PËRKRAHJA E PRODHUESVE TË QUMËSHTIT 2022

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, nr.14-400/04-223327/22, të datës, 14.10.2022, ftojme fermerët e komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për prodhim të qumështit, 2022.

Fermerët që do të përkrahen duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit, të dorëzuar në qumështore të licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështoret e licencuara;
- Të kenë kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;
- Të kenë dorëzuar së paku 2000 (dy mijë) litra qumësht dhe më së shumti deri në 30000(tridhjetë mijë) litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj;
- Subvencionimi do të bëhet për litër qumësht të dorëzuar, brenda kornizave prej më së paku 2000 deri 30000 litra.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;
- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
- Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëra nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështore të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit;
- Dëshmia nga banka për sasinë e qumështit të shitur;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit” (e lëshuar nga projekti).

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës

Data e aplikimit prej 18.10.2022 deri më 31.10.2022.